



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i dosjes: KSC-CC-PR-2020-09

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 5 qershor 2020

Klasifikimi: Publik

**Urdhër mbi riklasifikimin e shtojcës A të referimit të Rregullores së Procedurës
dhe të Provave drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese**

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke u bazuar në rregullën 82(5) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë urdhër në lidhje me riklasifikimin e shtojcës A të parashtrimit të titulluar “Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit”¹.

1. Më 1 maj 2020, Kryetarja i referoi rregullat e miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020 në përputhje me nenin 19(4) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullën 7(5) të Rregullores, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese për shqyrtim në përputhje me nenin 19(5) të Ligjit.² Ndryshimet e miratuara iu bashkëngjitën referimit si konfidenciale për të garantuar privatësinë e kuvendimeve të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

2. Më 22 maj 2020, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese lëshoi “Aktgjykim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020” duke i përfunduar në këtë mënyrë kuvendimet e veta.³

3. Meqenëse kuvendimet tashmë kanë përfunduar dhe për këtë arsye nuk ekzistojnë më arsyet për klasifikimin e tanishëm, shtojca A duhet të riklasifikohet si publike.

PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA

¹ KSC-CC-PR-2020-09, F00001, Referim i ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, publik me shtojcë konfidenciale, 1 maj 2020 (“Referimi”).

² Po aty.

³ KSC-CC-PR-2020-09/F00006, Aktgjykim mbi referimin e ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të miratuara nga Plenarja më 29 dhe 30 prill 2020, publik, 22 maj 2020.

Urdhëron riklasifikim si publik të shtojcës A të “Referimit të ndryshimeve të Rregullores së Procedurës dhe të Provave drejtuar, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese”, dosja nr. KSC-CC-PR-2020-09, me datë 1 maj 2020.

/nënshkrim/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E enjte, 5 qershor 2020
Në Hagë, Holandë.